

**Televizioni Ora News transmetoi një speciale për veprimtarinë e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, ndërsa kronika të veçanta dhanë edhe News24 dhe Televizioni Alsat. Më poshtë artikujt e botuara në të përditshmet "Shekulli" dhe "Mapo"**

## **Gazeta Shekulli**

### **Studimi, 74 % e prindërve të pakënaqur me cilësinë e teksteve**

Eglantina Bardhi

Sipas monitorimit të Altertekstit nga Fondacioni SOROS, konstatohen probleme në cilësinë e teksteve, komisionet e miratimit dhe shpërndarjen

Tekste që nuk kuptohen nga nxënësit, abuzime me faturat e librave në kurriz të prindërve, anomali në miratimin e teksteve dhe plot probleme me cilësinë e teksteve. Këto janë disa nga problematikat që kanë dalë falë një studimi që realizoi gjatë vitit 2010-2011 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), të cilat i prezantoi dje në workshopin me temë: "Përmirësimi i politikës dhe praktikës 'Altertekst' nëpërmjet pjesëmarrjes së gjerë".

Në prezantim morën pjesë drejtori i OSFA, Andi Dobrush, specialistë të arsimit dhe këshilltari i MASH-it, z. Jovan Kristiqi. Dritan Nelaj, koordinator i programit të Arsimit pranë OSFA-s, shpjegoi se përgjatë monitorimit u intervistuan 17 administratorë të shtëpive botuese të përfshira në hartimin e tekstit mësimor, 202 mësues anëtarë të Komisioneve të Përzgjedhjes së Teksteve në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, si dhe 861 prindër.

#### **Cilësia e teksteve**

Të pyetur rreth vështirësive që hasin fëmijët në të përvetësuarit e dijeve, prindërit konfirmojnë se 74.1% e nxënësve hasin vështirësi përgjatë procesit të nxënies. Kështu, 59% e prindërve të intervistuar mendojnë se arsyeja e këtyre vështirësive është cilësia e dobët e teksteve.

Monitorimi tregon se 56.4% e prindërve të intervistuar kanë vënë re ndryshime në përmbajtjen e teksteve, nga viti në vit e ndjekur kjo nga, 42.9% e prindërve të intervistuar, të cilët nuk kanë shquar ndryshime në këtë drejtim.

Të pyetur lidhur me zbatimin e mekanizimit të vjeljes së përshtypjeve të përdoruesve të tekstit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij, 50.2 % e mësuesve përgjigjen se u është marrë mendimi rreth problemeve dhe vështirësive që kanë hasur gjatë përdorimit të tekstit, ndërsa 47.8 % e tyre shprehen negativisht.

## Komisionet

Sipas "Paketën Informuese Altertekst 2010-2011", komisionet e miratimit të teksteve duhet të kishin në përbërjen e tyre një prind, gjë që është zbatuar vetëm në 20 % të rasteve. Vetëm 2.6% e prindërve të pyetur rezultojnë të jenë në dijeni të prindërve, të cilët kanë qenë anëtarë të komisioneve të përzgjedhjes së teksteve.

Një përqindje mjaft e vogël, vetëm 8.5% e prindërve anëtarë të komisioneve pohojnë se mendimi i tyre lidhur me tekstet është marrë në konsideratë nga anëtarët e tjerë të komisionit. Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore ngarkohen me trajnimin e mësuesve rreth procesit dhe procedurave të përzgjedhjes së teksteve, gjë që ka ndodhur vetëm në 49% të rasteve.

Të pyetur lidhur me punën e komisioneve të përzgjedhjes së teksteve 35,3% e administratorëve të shtëpive botuese mendojnë se vendimmarrja ka qenë e keqe, ndërsa 35,3% e tyre mendojnë se vendimmarrja ka qenë e mirë.

## Shpërndarja

Të pyetur rreth cilësisë së procesit të shpërndarjes së teksteve 39.8% e prindërve mendojnë se shpërndarja ishte më e mirë këtë vit, ndërsa 13.3% e tyre konfirmojnë të kundërtën e ndjekur kjo nga 46.4% e të pyeturve, të cilët nuk shquajnë ndonjë ndryshim krahasuar me vitin e shkuar.

Rezultatet e monitorimit sugjerojnë se tekstet nuk kanë mbërritur në sasinë e duhur për të gjithë titujt, pasi vetëm 29.9% e prindërve kanë mundur t'i sigurojnë të gjitha tekstet që me vizitën e parë në shkollë, ndërsa rreth 28% e prindërve të intervistuar u është dashur të vizitojnë shkollën në tre, apo më shumë raste për të siguruar të gjitha tekstet e nevojshme.

Pajisja e blerësit të tekstit me faturë tatimore ka qenë një rregull i pazbatuar në shumicën e rasteve, pasi 81% e prindërve të pyetur nuk janë pajisur me faturë tatimore. Të pyetur rreth asaj sesi do të ishte më mirë tregtimi i teksteve në shkollë apo librari, 83% e prindërve preferojnë tregtimin e teksteve në shkollë, ndërsa vetëm 15.8% e tyre preferojnë tregtimin e teksteve në librari.

## Gazeta Mapo

### Librat, mbi 70% e nxënësve hasin vështirësi

**SHKRUAN: Jonida Tashi 11-02-2011 11:06**

Pjesa më e madhe e nxënësve në arsimin parauniversitar hasin vështirësi me tekstet shkollore, mbi të gjitha për shkak të cilësisë së dobët të tyre. Tashmë ky shqetësim i vazhdueshëm i prindërve, drejtuar mësuesve kujdestarë të fëmijëve apo edhe drejtuesve të shkollave, është përkthyer në shifra nëpërmjet një anketimi që Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS) ka publikuar së fundmi. Sipas

monitorimit të SOROS, prindërit, të pyetur rreth vështirësive që hasin fëmijët në të përvetësuarit e dijeve, konfirmojnë se 74.1% e nxënësve ndeshin vështirësi përgjatë procesit të nxënies. Kështu, 59% e prindërve të intervistuar mendojnë se arsyeja e këtyre vështirësive është cilësia e dobët e teksteve. Për më tepër, monitorimi tregon se 56.4% e prindërve të intervistuar kanë vënë re ndryshime në përmbajtjen e teksteve, nga viti në vit, e ndjekur kjo nga 42.9% e prindërve të intervistuar, të cilët nuk kanë shquar ndryshime në këtë drejtim. Gjithashtu, 43.8% e prindërve të intervistuar mendojnë se në përgjithësi, cilësia e teksteve është rritur, ndërsa vetëm 20% e tyre mendojnë se ka rënie në cilësi, e ndjekur kjo nga 35.2% e prindërve, të cilët nuk shquajnë ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Nisur nga ky problem me tekstet shkollore që nuk është i vetmi, SOROS ka evidentuar të gjitha të dhënat e nxjerra në bashkëpunim me një grup ekspertësh, përgjatë periudhës gusht-nëntor 2010, për monitorimin e zbatimit të procesit Altertekst 2010, në qytetin e Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës, të cilat do ia dorëzojë zyrtarisht edhe Ministrisë së Arsimit. Një tjetër problem i evidentuar nga monitorimi i SOROS-it, për paketën Altertekst 2010, është ai që ka të bëjë me shpërndarjen dhe shitjen e librave. Kështu, të pyetur rreth cilësisë së procesit të shpërndarjes së teksteve, 39.8% e prindërve mendojnë se shpërndarja ishte më e mirë këtë vit shkollor, ndërsa 13.3% e tyre konfirmojnë të kundërtën, e ndjekur kjo nga 46.4% e të pyeturve, të cilët nuk vërejnë ndonjë ndryshim krahasuar me vitin e shkuar. “Rezultatet e monitorimit sugjerojnë se tekstet nuk kanë mbërritur në sasinë e duhur për të gjithë titujt, pasi vetëm 29.9% e prindërve kanë mundur t’i sigurojnë të gjitha tekstet që me vizitën e parë në shkollë, ndërsa rreth 28% e prindërve të intervistuar u është dashur të vizitojnë shkollën në tre apo më shumë raste, për të siguruar të gjitha tekstet e nevojshme”, - thuhet në monitorim. Po ashtu, pajisja e blerësit të tekstit me faturë tatimore ka qenë një rregull i pazbatuar në shumicën e rasteve, pasi 81% e prindërve të pyetur nuk janë pajisur me faturë tatimore, çka do të thotë se ata nuk do të përfitojnë subvencion sipas ligjit. Lidhur me shitjen e librave, nëse do të ishte më mirë tregtimi i teksteve në shkollë apo librari, 83% e prindërve preferojnë tregtimin e teksteve në shkollë, ndërsa vetëm 15.8% e tyre preferojnë tregtimin e teksteve në librari.